REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LUSHNJE

Nr. 2554/1 Prot.

Lushnje më, 19/03/2025

PROJEKT-VENDIM

NR. 29 **DATË** 19/03/**2025**

"PËR SHFUQIZIMIN E VKB-SË NR. 96 DATË 28.10.2024 DHE MIRATIMIN E NDËRTIMIT TË QENDRËS SHËNDETËSORE NË TRUALLIN E PASURISË NR. 158/79, ME EMËRTIM NË INVENTAR SHKOLLA 8 VJEÇARE, FSHATI GORRE, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLONJË, BASHKIA LUSHNJE."

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e radhës në datë ____/____/2025, në mbështetje të nenit 9 pika 1.2/a/c, neni 23 dhe neni 54, pika 1, gërma "e", të ligjit nr.139 datë 17.12.2015 "Për vetëqeverisjen vendore", nenit 55, 113, pika 2 të Kushtetutës se Republikës të Shqipërisë, nenit 4, neni 5, pika 1.3, gërma a, neni 12, neni 22 dhe kreu IV të ligjit nr.107 datë 31.07.2014 "Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit", i ndryshuar, VKM-së nr. 947 datë 02.09.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, që transferohen në pronësi ose në përdorim të Komunës Kolonjë, të Qarkut të Fierit", nenit 5, pika 3 të ligjit nr. 10107, datë 30.3.2009 "Për kujdesin shëndetësor në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, dhe nenit 113 të ligjit nr. 44/2015 "Kodi i proçedurave administrative i Republikës së Shqipërisë, i:

PROPOZOJMË:

I. Shfuqizimin e VKB-së nr. 96 datë 28.10.2024 "Mbi prishjen e katit të parë teknik dhe rikonstruksionin e katit përdhe në objektin e Qendrës Shëndetësore Gorre, Njësia Administrative Kolonjë".

II. Ndërtimin e Qendrës Shëndetësore në truallin e pasurisë nr. 158/79, me emërtim në inventar "Shkolla 8 vjeçare", fshati Gorre, Njësia Administrative Kolonjë, Bashkia Lushnje, me sipërfaqe totale trualli 3775 m2, nga ku sheshi i ndërtimit për objektin është 259 m^2 dhe sipërfaqja e objektit të ri është 90 m^2.

9333/2
02.12.2024.

DR. PLANIFIKIMIT

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E BRENDSHME
INSPEKTORATI KOMBËTAR I MBROJTJES SË TERRITORIT
DREJTORIA E ZBATIMIT TË VENDIMEVE

Nr. 6643/3 **prot.** **Tiranë,më.** 27 11 **.2024**

Lënda: Kthim Përgjigje .

BASHKIA LUSHNJE

Lagjia "Kongresi i Lushnjës" Tel:+35535222139

Referuar shkresës tuaj me Nr.9333/1 prot.datë.18.11.2024 protokolluar pranë IKMT së me Nr.6643/2 prot. datë 20.11.2024,

"Kërkesë për bashkëpunim" në zbatim të vendimit nr. 96 datë.28.10.2024 të Këshillit Bashkiak Lushnje. për prishjen e katit parë teknik dhe rikonstruksionin e katit përdhe të objektit të Qendrës Shëndetësore Gorre Njësia Administrative Kolonjë Bashkia Lushnje.

U ngrit një grup pune nga Drejtoria e Zbatimit të Vendimeve të IKMT së dhe morën kontakt me përfaqësuesit e Bashkisë Lushnje panë nga afër objektin për të cilin Ju kërkoni ndërhyrje
Nga verifikimi dhe indpektimi që ju bë objektit rezulton se:
Objekti është një ndërtim i vjetër dhe i amortizuar nga lagështira, soleta e katit përdhe është e dobët nuk mbanë peshën e materialeve inerte që do të bien gjatë prishjes dhe rrezikon që të shembet i gjithë objektit.

Ndodhur para kësaj situate IKMT ja e ka të pamundur mbështetjen .

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin !

KRYEINSPEKTOR

Dallëndyshe BICI

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KESHILLI BASHKIAK LUSHNJE

Nr 8586 Prot.
/2

Lushnje, më 29/10/2024

VENDIM

NR. 96 DATË 28/10/2024

"MBI PRISHJEN E KATIT TE PARE TEKNIK DHE RIKONSTRUKSIONIN E KATIT PËRDHE NË OBJEKTIN E QENDRËS SHËNDETËSORE GORRE, NJËSIA ADMINISTRATIVE KOLONJË"

Këshillit Bashkiak në mbledhjen e datës 28/10/2024 pasi mori në shqyrtim relacionin e paraqitur.në mbështetje të nenit 8 pika 2,nenit 9,pika 1.2 ,shkronja "a" dhe "c" nenit 54 gërma "e" të Ligjit nr.139/2015,"Për vetqeverisjen vendore",i ndryshuar,neni 113,pika 2 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë,neni 4,neni 5,pika 1.3 gërma "a",neni 12,neni 22 të ligjit 107 datë 31.07.2014"Për planifikimin dhe zhvillimin e territorit" i ndryshuar dhe VKM nr.947 datë 02.09.2009 "Për miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike,shtetrore që transferohen në pronësi ose në përdorim të Bashkisë Lushnje,Qarkut Fier":

VENDOSI:

I. Të miratoj prishjen e katit të parë teknik në objektin e Qendrës Shëndetësore Gorre,Njësia Administrative Kolonjë të ndodhur në pasurinë me nr.158/73, Zona Kadastrale 1813 e llojit truall+ndërtesë me sipërfaqe 300 m2,nga ku 125 m2 është ndërtesë e cila është pronë në inventar të Bashkisë Lushnje.

II. Të miratojë rikostruksionin e katit përdhe në objektin e Qendrës Shëndetësore Gorre,Njësia Administrative Kolonjë me financim nga Raiffeisenbank,në vlerën 50 000 (pesëdhjetëmijë) euro donacion.

III. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Inspektoriati i Mbrojtjes së Territorit Vendor,Policia Bashkiake,Njësia Administrative Kolonjë.

IV. Ky vendim hyn në fuqi 10 dite pas shpalljes.

KRYETARI I KESHILLIT

Erjet Dhima

REPUBLIKA E SHQIPËRISË BASHKIA LUSHNJE

Adresa:Lagjia "Kongresi i Lushnjes" Tel:+355 35 222130 E-mail:bashkia_lushnje@yahoo.com

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
Këshilli i Ministrave

V E N D I M

Nr. 947, datë 2.9.2009

PËR

MIRATIMIN E LISTËS PËRFUNDIMTARE TË PRONAVE TË PALUAJTSHME PUBLIKE, SHTETËRORE, QË TRANSFEROHEN, NË PRONËSI OSE NË PËRDORIM, TË KOMUNËS KOLONJË, TË QARKUT TË FIERIT

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të neneve 3 e 17, të ligjit nr.8744, datë 22.2.2001, "Për transferimin e pronave të paluajtshme publike të shtetit në njësitë e qeverisjes vendore", të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

V E N D O S I :

1. Miratimin e listës përfundimtare të pronave të paluajtshme publike, shtetërore, brenda juridiksionit, territorial dhe administrativ, të komunës Kolonjë, të qarkut të Fierit, që transferohen, në pronësi ose në përdorim, të kësaj komune, sipas lidhjes 1, që i bashkëlidhet këtij vendimi dhe është pjesë përbërëse e tij.

   Lista me 59 (pesëdhjetë e nëntë) fletë, që i bashkëlidhet këtij vendimi, përfundon me numrin rendor 318 (treqind e tetëmbëdhjetë).

2. Ngarkohen ministri i Brendshëm, kryeregjistruesi i Pasurive të Paluajtshme të Republikës së Shqipërisë dhe komuna Kolonjë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në "Fletoren zyrtare".

KRYEMINISTRI

SALI BERISHA

MINISTRI I BRENDSHËM

BUJAR NISHANI

Komuna Kolonjë

Lidhja 1

1-9	Prona që përdoren për realizimin e programeve arsimore.	Në pronësi
10-13	Prona që përdoren për realizimin e funksioneve në shëndetin publik.	Në pronësi
98-106	Prona që përdoren për realizimin e programeve kulturore sportive	Në pronësi
112-117	Sherbim funeral	Në pronësi
171-179,184-192,194,195,308,315,	Infrastrukture (rruge vendore lulishte,sheshe,trotuar dhe sherbime publike)	Në pronësi
118-168,303-307,309-314,316-318	Troje te lira dhe hapesira publike te pazena midis ndertesave ose objekteve te cdo lloji	Në përdorim
202-209	Prona që përdoren per ushtrimin e funksioneve në fushen e ujesjelles - kanalizimeve.	Në pronësi
302	Prona qe perdoren ne fushen e ndriçimit publik	Në pronësi
14-26	Prona që përdoren në fushën e mbrojtjes civile	Në pronësi
40-97	Prona qe perdoren ne fushen e zhvillimit ekonomik	Ne pronesi
180-183	Prona që perdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka produktive)	Në përdorim
27-39, 219, 244 , 251, 261, 266,276,279,287,291	Prona që perdoren në fushën e bujqësisë dhe të ushqimit (toka jo produktive kanale të treta)	Në pronësi

MINISTRI

Bujar NISHANI

NR.PROT.2630/1
DATË 7.9.2009

PRESIDENCËS
MINISTRISË SË BRENDSHME
MINISTRISË SË FINANCAVE
MINISTRISË SË DREJTËSISË
MINISTRISË SË EKONOMISË, TREGTISË DHE ENERGJETIKËS
MINISTRISË SË MBROJTJES
MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SHKENCËS
MINISTRISË SË BUJQËSISË, USHQIMIT DHE MBROJTJES SË KONSUMATORIT
MINISTRISË SË TURIZMIT, KULTURËS, RINISË DHE SPORTEVE
KËSHILLIT TË QARKUT TË FIERIT
AGJENCISË SË KTHIMIT DHE KOMPENSIMIT TË PRONAVE
ZYRËS QENDRORE TË REGJISTRIMIT TË PASURIVE TË PALUAJTSHME
QENDRËS SË PUBLIKIMEVE ZYRTARE

Gjergj LEZHJA
Sekretari i Përgjithshëm

Nr. Rend.	A			B			C			
	Zona Kadastr. & Indeksi i Hartes	Nr. Pasurise	Lloji i Prones	Emri i Prones Adresa	Sip. Totale e Prones (m2)	Nga Sip. Totale: Sa Ndertese (m2)	Funksioni per te cilin perdoret Prona	Institucioni / Enti me pergjegjesi administrative	Institucioni / Enti perdorues Statusi juridik i perdorimit	Te dhena te tjera (Shenime te veçanta)
1	2	3	4	5	6	7	8	9	10	11
5	101-C	158/79	Truall Ndertese	Shkollae 8 Vjecare Gorre	2775	630	Arsim parauniversitar	Ministria e Arsimit dhe e Shkences	Drejtoria Asimore Lushnje	

1009/1
10.03.2025

dr. Planifikimit Territorit
Per shqyrtim materiali per
vetëdhe ligje

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORIA E PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORIA E SHËRBIMEVE TË PËRGJITHSHME

Nr.1512/1 prot.

Tiranë, më 07.03.2025

Lënda: Kthim përgjigje.

BASHKISË LUSHNJË
Lagjja "Kongresi", Lushnjë.

Në përgjigje të shkresës suaj protokolluar në MAS me nr. 784 prot., datë 31.01.2025, me lëndë: "Kërkesë për konfirmim", ju informojmë si më poshtë:
Ministria e Arsimit dhe Sportit me anë të shkresës nr. 784/1 prot., datë 07.02.2025, i'u drejtua me kërkesë për informacion Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier dhe Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Lushnjë, për të verifikuar dhe vlerësuar nëse ndërtimi i qendrës shëndetësore në koordinatat e cituara nga ana juaj cënon mirëfunksionimin e realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Gorre.
Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar me anë të Urdhrit nr. 75, datë 19.02.2025, ka caktuar znj. Ornela Tafaj, me detyrë inxhinere në Drejtorinë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Durrës, si person përgjegjës për të kryer verifikimin dhe vlerësimin nëse ndërtimi i qendrës shëndetësore në koordinatat e cituara nga ana juaj cënon mirëfunksionimin e realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Gorre, duke qenë se Drejtoria Rajonale e Arsimit Parauniversitar Fier nuk ka inxhinier të emëruar në këtë pozicion.
Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnjë me anë të shkresës me nr. 393/2, datë 05.03.2025, drejtuar Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar dhe Drejtorisë Rajonale të Arsimit Parauniversitar Fier, shprehet se: "*... ju bëjmë me dije se ndërtimi i qendrës shëndetësore Gorre, nuk ndikon në mirëfunksionimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore*".
Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar me anë të të shkresës me nr. 692/1 prot., datë 05.03.2025, përcjell kthim përgjigjen e bërë nga Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnjë.
Për sa më sipër, Ministria e Arsimit dhe Sportit shprehet në parim dakord për ndërtimin e qendrës shëndetësore në koordinatat e cituara nga ana juaj.
Bashkëlidhur gjeni kthim përgjigjen me nr. 692/1 prot., datë 05.03.2025, të Agjencisë Kombëtare të Arsimit Parauniversitar, Urdhrin nr. 75, datë 19.02.2025, raportin e vlerësimit dhe shkresën nr. 393/2 prot., datë 05.03.2025 të Zyrës Vendore të Arsimit Parauniversitar Lushnjë.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin,

SEKRETARI I PËRGJITHSHËM

Erzen Tola

REPUBLIKA E SHQIPËRISË MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT TIRANË

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 692/1 Prot. Tiranë, më 05.03.2025

Lënda: Kthim përgjigje

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
DREJTORISË SË PËRGJITHSHME EKONOMIKE DHE SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
DREJTORISË SË SHËRBIMEVE MBËSHTETËSE
Adresë: Rruga e Durrësit, Nr.23, Tiranë

Në përgjigje të shkresës, nr. 784/1 prot., date 07.02.2025, "Kërkesë për informacion" ju sqarojmë se Agjencia Kombëtare e Arsimit Parauniversitar me Urdhër nr. 75, datë 19.02.2025, ka caktuar Znj. Ornela Tafaj, me detyrë inxhiniere në DRAP Durrës, si person përgjegjës për të kryer verifikimin dhe vlerësimin, nëse ndërtimi i qendrës shëndetësore në koordinatat e cituara nga ana e bashkisë Lushnje cënon mirëfunksionimin e realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Gorre, duke qenë se DRAP Fier nuk ka inxhinier të emëruar në këtë pozicion.
Znj. Ornela Tafaj, si person përgjegjës, me shkresën nr. 462 prot., datë 27.02.2025 "Shkresë përcjellëse" ka dërguar raportin e vlerësimit ku ka mabjtur qëndrimin se ndryshimi i llojit të pronës dhe ndryshimi i inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore nuk është në kompetencë e jonë si institucion. Etj.
Me shkresën nr. 393/2 prot., datë 05.03.2025 "Informacion mbi ndërtimin e qëndrës shëndetësore Gorre", Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnje si njësi e ofrimit direkt të shërbimeve të cilat përfshijnë zyrat vendore të arsimit parauniversitar dhe institucionet arsimore të sistemit parauniversitar publik, ka bërë me dije se ndërtimi i qëndrës shëndetësore Gorre, nuk ndikon në mirëfunksionimin e procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore

Bashkëlidhur po ju dërgojmë shkresën nr. 462 prot., datë 27.02.2025 "Shkresë përcjellëse", shkresën nr. 393/2 prot., datë 05.03.2025 "Informacion mbi ndërtimin e qëndrës shëndetësore Gorre", Zyra Vendore e Arsimit Parauniversitar Lushnje.

Duke ju falënderuar për bashkëpunimin!

DREJTORI I PËRGJITHSHËM
Rezarta Alla

Adresa: Rruga"Aleksandër Moisiu", Tiranë
AKAP.Tirane@arsimi.gov.al

AGJENCIA KOMBËTARE
E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Nr. 692 Prot.
Datë,më 05 03 2025

Outlook

Fw: Kërkes për informacion mbi ndërtimin e qendres shëndetsore Gorre

From DRAP Fier <DRAPFier@arsimi.gov.al>
Date Wed 05/03/2025 15:17
To AKAP Tirane <AKAPTirane@arsimi.gov.al>
Cc Rezarta Alla <Rezarta.Alla@arsimi.gov.al>; Zaira Gjika <Zaira.Gjika@arsimi.gov.al>

1 attachment (161 KB)
Informacion mbi ndërtimin e qendrës shëndetsore Gorre.PDF;

BashPërshëndetje,

Bashkëlidhur gjeni informacionin e kërkuar.

Duke ju falënderuar
DRAP Fier

From: ZVA Lushnje <ZVAlushnje@arsimi.gov.al>
Sent: Wednesday, March 5, 2025 3:08 PM
To: DRAP Fier <DRAPFier@arsimi.gov.al>; Zaira Gjika <Zaira.Gjika@arsimi.gov.al>
Cc: Zeniola Hoxha <Zeniola.Hoxha@arsimi.gov.al>
Subject: Fw: Kërkes për informacion mbi ndërtimin e qendres shëndetsore Gorre

Përshëndetje!

Bazuar në emailin gjeni bashkëlidhur informacionin.

ZVAP Lushnjë.

From: AKAP Tirane <AKAPTirane@arsimi.gov.al>
Sent: Wednesday, March 5, 2025 14:06
To: DRAP Fier <DRAPFier@arsimi.gov.al>; ZVA Lushnje <ZVAlushnje@arsimi.gov.al>
Cc: Rezarta Alla <Rezarta.Alla@arsimi.gov.al>
Subject: Re: Kërkes për informacion mbi ndërtimin e qendres shëndetsore Gorre

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR FIER
ZYRA VENDORE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR LUSHNJË

Nr. 393/2 prot. Lushnje,më 05.03 2025

Lënda : Informacion mbi ndërtimin e qendrës shëndetësore Gorre

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Tiranë

DREJTORISË RAJONALE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Fier

Në vijim të shkresës së MAS nr. 784/1, datë 07.02.2025 "Kërkesë për informacion", Urdhrit të AKAP nr.75, datë 19.02.2025 "Për caktimin e personit përgjegjës për verifikimin dhe vlerësimin e objektit", dhe bazuar në raportin e vlerësimit mbi verifikimin fizik të shkollës Gorre protokolluar me nr.393/1 datë 05.03.2025 , ju bëjmë me dije se ndërtimi i qendrës shëndetësore Gorre, nuk ndikon në mirëfunksionimin e procesit mësimore dhe aktivitete shkollore.

DREJTOR
Zeniola HOXHA

Adresa: Rruga "Qemal Stafa" Lushnje email : zvalushnje@arsimi.gov.al tel:+35535222135

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR

Nr. 508/1 Prot.

Tiranë, më 19.02. 2025

URDHËR

Nr. 75, datë 19.02. 2025

PËR

CAKTIMIN E PERSONIT PËRGJEGJËS PËR VERIFIKIMIN DHE VLERËSIM TUAJ

Në mbështetje të Ligjit Nr.44/2015, "Kodi i Procedurës Administrative i Republikës së Shqipërisë", ligjit 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", të ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr. 99, datë 27.02.2019 "Për krijimin, mënyrën e organizimit e të funksionimit të Drejtorisë së Përgjithshmë të Arsimit Parauniversitar", Vendimit të Këshillit të Ministrave Nr.159, datë 01.03.2017 "Për miratimin e standarteve të kopshtit", Rregullores Nr. 4699/1 prot., datë 30.04.2019 të Ministritë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Rregullore për organizimin dhe funksionimit e Drejtorisë së Përgjithshme të Arsimit Parauniversitar", Urdhërit Nr.31, datë 28.01.2020 të Ministrit të Arsimit, Sportit dhe Rinisë "Për miratimin e rregullores për funksionimin e institucioneve arsimore parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, Udhëzimit Nr.15, datë 12.07.2013 "Për procedurat e posaçme për shqyrtimin e kërkesa për licencë të institucionev arsimore private dhe institucioneve arsimore plotësuese private parauniversitare" të ndryshuar, si dhe të shkresës Nr.784/1 prot., datë 07.02.2025 "Kërkesë për informacion" të Ministrisë së Arsimit dhe Sportit, si dhe aktet e tjera ligjore dhe nënligjore në fuqi në fushën e arsimit parauniversitar

U R D H Ë R O J :

1. Caktimin e Znj. Ornela Tafaj, si person përgjegjës për të kryer verifikimin dhe vlerësimin tuaj nëse ndërtimi i qendrës shëndetësore në koordinatat e cituara nga ana e bashkisë Lushnje cënon mirëfunksionimin e realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Gorre.
2. Znj. Ornela Tafaj, si person përgjegjës do të kryejë verifikimin dhe vlerësimin tuaj nëse ndërtimi i qendrës shëndetësore në koordinatat e cituara nga ana e bashkisë Lushnje cënon mirëfunksionimin e realizimit të procesit mësimor dhe aktiviteteve shkollore për nxënësit e shkollës 9-vjeçare të fshatit Gorre, në datët 20-21.02.2025 si dhe të hartojë raportin e vlerësimit me gjetjet e konstatuara dhe rekomandimet.
3. Raporti i monitorimit, verifikimin dhe vlerësimin tuaj, do të depozitohet pranë Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

Ky Urdhër hyn në fuqi menjëherë.

DREJTOR I PËRGJITHSHËM

Rezarta ALLA

Adresa: Rruga"Aleksandër Moisiu", Tiranë
AKAPTirane@arsimi.gov.al

AGJENCIA KOMBËTARE
E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
Nr. 672 Prot.
Datë,më 03.03.2025

REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E ARSIMIT DHE SPORTIT
AGJENCIA KOMBËTARE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
DREJTORIA RAJONALE E ARSIMIT PARAUNIVERSITAR DURRËS

Nr. 462/7 Prot. *Durrës* më, 27.02.2025

Lënda : *Shkresë përcjellëse.*

MINISTRISË SË ARSIMIT DHE SPORTIT
(Rruga e Durrësit, Tiranë)

AGJENCISË KOMBËTARE TË ARSIMIT PARAUNIVERSITAR
(Rruga Aleksandër Mojsiu, Tiranë)

Në përgjigje të Urdhërit Nr.75 prot, datë.19.02.2025, si dhe të shkresës Nr.784/1 prot, datë 07.02.2025 "Kërkesë për konfirmim" të Bashkisë Lushnje, bashkëlidhur po ju dërgojmë raportin e vlerësimit dhe dokumentacionin mbështetës.

Duke ju falenderuar për mirëkuptimin,

D R E J T O R
Hazbi LIKA


Raport vlerësimi

Në përgjigje të Urdhërit Nr.75 prot, datë.19.02.2025, si dhe të shkresës Nr.784/1 prot, datë 07.02.2025 "Kërkesë për konfirmim" të Bashkisë Lushnje, u krye verifikimi fizik në ambientin e shkollës "Shkolla e Bashkuar Gorre" në fshatin Gorre, Njësia Administrative Kolonjë, Bashkia Lushnje.


Nga verifikimi fizik konstatohet se shkolla "Shkolla e Bashkuar Gorre" pozicionohet në këto koordinata gjeografike :

- KRRGJSH 469500.18, 4524946.27 (godina e shkollës 9 – vjeçare)
- KRRGJSH 469468.26, 4524948.51 (godina e shkollës së mesme).


Përsa i përket fushës sportive me Nr. Pasurie 158/79 Zona Kadastrale 1813 ajo pozicionohet në këto koordinata gjeografike KRRGJSH 469590.62, 4524965.59 nga krahu i djathtë i murit rrethues të godinës së shkollës 9 – vjeçare, me sipërfaqe afërsisht 16900 m^2 (e dhënë nga matje në gjeoportalin ASIG).



(Foto të marrë nga ASIG, ortofoto e vitit 2015)



(Foto të marrë nga ASIG, ortofoto e vitit 1994)



(Foto të marrë nga Google Earth, fotografim ajror i vitit 2023)

Institucionet arsimore kanë vepruar si dy institucione të pavarura të njohura si shkolla 9- vjeçare "Mihal Davidhi" Gorre dhe Gjimnazi "Pali Dine" Gorre, të rrethuara secila me mur rrethuar. Së fundmi, ato janë bashkuar duke u njohur si Shkolla e Bashkuar Gorre.

Fusha sportive me nr pasurie 158/79, Zona Kadastrale 1813, në anën jugore të saj rrethohet me mur me blloqe betoni, në anën lindore dhe në veri të saj me pemë të ndryshme (pisha etj), ndërsa në anën perëndimore të saj kufizohet pjesërisht me murin rrethues të shkollës 9 vjeçare dhe pjesa tjetër me pemë.

Ashtu siç vihet re dhe në fotografimin ajror në këtë fushë janë të shtruara dhe të pajisura me rrjeta e kosh për basketboll përkatësisht 2 fusha volejbolli, 2 fusha basketbolli. Pjesa e qendrës së kësaj fushe përdoret si fushë futbolli. Këto fusha janë të shtruara me kontribut të nxënësve të shkollës, mësuesve dhe vullnetar të banorëve të zonës, gjithashtu janë të hapura dhe të parrethuara.

Gjatë verifikimit fizik u konstatua se të dyja godinat kanë nevojë për rikonstruksion dhe përmirësim të kushteve infrastrukturore, pasi konstatohen probleme me lagështinë, hidroizolimin dhe rënien e suvatimit në pjesë të ndryshme të shkollës.

Godinat e shkollës janë të ndërtuara rreth vitit 1967 dhe janë rikonstruktuar në vitin 2008 godina e gjimnazit dhe në 1996 godina e shkollës 9 – vjeçare.

Kriteret e përcaktuara në skedën teknike të shkollës I referohen VKM Nr.319 datë 12.04.2017 "Për miratimin e standarteve të projektimit të shkollave".
Në skedën teknike të vënë në dispozicion nga titullari I IAP Shkolla e Bashkuar Gorre konstatohet se ky institucion arsimor :

- Përsa I përket satfit mësimor dhe personeli administrativ ky institucion ka 1 titullar, 21 mësues, 3 mësues ndihmës, 1 psikolog, 1 roje dhe 2 sanitare.
- Ka një numër nxënësish prej 152 nxënës.
- Për ngrohjen përdoret soba me dru zjarri dhe rezistenca elektrike për gjimnazin.
- Ka dy fusha volejbolli, 2 fusha basketbolli dhe një fushë futbolli

- Ky institucion arsimor është shkollë qendër komunitare dhe ofron aktivitete të ndryshme ku ndërtohet partneriteti shkollë-familje-komunitet dhe bashkëpunohet për zhvillimin e potencialit të plotë të çdo nxënësi.
- Nuk ka një kënd gjimnastikor apo fushë tenisi
- Nuk ka dhomë mjeku, dhomë stomatologu, ambient për sekretariatin dhe administatën
- Nuk ka nyje hidrosanitare dhe pjerrina / rampa për personat me aftësi të kufizuar e fëmijët me aftësi të kufizuar
- Nuk ka sistem tokëzimi dhe rrufepritësi
- Nuk ka sistem sigurie (kamera, alarme dhe akses kontrolli)
- Nuk ka sistem të mbrojtjes kundër zjarrit dhe dedektimit të tij
- Nuk ka sistem të njoftimit zanor
- Nuk ka dalje emergjence / evakuimi

Referuar shkresës së bashkisë Lushnje me Nr. 1009 Prot datë 29.01.2025, qendra shëndetësore që do të ndërtohet do të jetë **me sipërfaqe 90 m²** dhe është projektuar të ndërtohet **në pasurinë me nr. 158/79 e llojit truall + ndërtesë, Zona Kadastrale 1813, me funksion Arsim Parauniversitar, emërtuar "Shkolla 8 vjeçare" Gorre, me ent përdorues Drejtoria Arsimore Lushnje.**

Në planvendosjen bashkëlidhur shkresës së bashkisë Lushnje me Nr. 1009 Prot datë 29.01.2025, vihet re se:

- Rrethimi I qendrës shëndetësore do të nisë 4 m larg pasurisë me nr 158/74, ZK 1813 (nr. I pasurisë 158/74 ZK 1813 I marrë nga ASIG)
- Përfundimi I rrethimit të qëndrës shëndetësore do të përfundojë 20 m larg pasurisë me nr 158/74, ZK 1813 (nr. I pasurisë 158/74 ZK 1813 I marrë nga ASIG)

Ashtu siç vihet re dhe në planvendosjen e vënë në dispozicion, distanca midis rrethimit të qendrës shëndëtësore dhe fillimit të fushës së shtruar të basketbollit është 1 – 2 m.

➢ Konkluzion

-1- Fushat e bashketbollit dhe volejbollit janë të shtruara me kontribut të nxënësve të shkollës, mësuesve dhe vullnetar të banorëve të zonës, gjithashtu janë të hapura dhe të parrethuara. Ato janë në funksion të institucionit arsimor Shkolla e Bashkuar Gorre dhe të komunitetit.

-2- Fusha sportive me nr pasurie 158/79, Zona Kadastrale 1813, në anën jugore të saj rrethohet me mur me blloqe betoni, në anën lindore dhe në veri të saj me pemë të ndryshme (pisha etj), ndërsa në anën perëndimore të saj kufizohet pjesërisht me murin rrethues të shkollës 9 vjeçare dhe pjesa tjetër me pemë.

-3- Fusha sportive me nr pasurie 158/79, Zona Kadastrale 1813 është e **llojit truall + ndërtesë, Zona Kadastrale 1813, me funksion Arsim Parauniversitar, emërtuar "Shkolla 8 vjeçare" Gorre, me ent përdorues Drejtoria Arsimore Lushnje.**
Ndryshimi I llojit të pronës dhe ndryshimi I inventarit të pronave të paluajtshme shtetërore nuk është kompetencë e jonë si institucion.

-4- *Bazuar në Ligjin 69/2012 "Për Sistemin Arsimor Parauniversitar në Republikën e Shqipërisë", I ndryshuar, Kreu IV Drejtimi I Sistemit Arsimor Parauniversitar, Neni 28 :*

1. Njësia bazë e vetëqeverisjes vendore ka për detyrë *përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së shërbimit arsimor për të gjithë nxënësit në institucionet arsimore parauniversitare publike, në përputhje me legjislacionin në fuqi.*

2. Kompetencat kryesore të njësisë bazë të vetëqeverisjes vendore janë:
a) *ndërtimi dhe rikonstruksioni i godinave të institucioneve arsimore publike*, sipas standardeve të miratuara nga Këshilli i Ministrave, me fonde të Buxhetit të Shtetit ose me fonde nga transferta e pakushtëzuar ose të ardhurat e veta;
b) garantimi i paprekshmërisë së institucioneve arsimore në juridiksionin e saj, si dhe i mjediseve të tyre;
c) *ruajtja dhe mirëmbajtja e institucionit arsimor publik*;
ç) *garantimi i kushteve higjieno-sanitare e atyre të ngrohjes në godinat e institucioneve*

arsimore publike.

d) *planifikimin e nevojave për ndërtimin dhe rikonstruksionin e godinave të institucioneve arsimore parauniversitare pas marrjes së mendimit të ministrisë përgjegjëse për arsimin për planifikimin dhe shpërndarjen e nxënësve në territorin e njësisë së vetëqeverisjes vendore përkatëse*.